

KODI ZGJEDHOR

Neni 25/1: Procedura e votimit nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

(Shtuar me ligjin nr. 81/2024, datë 26.7.2024; ndryshuar titulli, pika 3 dhe shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 10/2025, datë 17.2.2025)

1. Votimi nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë quhet i çelur nga dita që KQZ-ja nis procedurat për dërgimin e dokumentacionit të votimit dhe dokumentacionit udhëzues në adresë të zgjedhësve nga jashtë vendit. Votimi nga jashtë vendit mbyllet në ditën e votimit, në orën e caktuar nga ky Kod për mbylljen e votimit në qendrat e votimit. Me mbylljen e votimit nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, KQZ-ja nuk mund të pranojë dhe përfshijë në numërim asnjë fletë votimi të mbërritur pas këtij orari, me përjashtim të zarfeve me fletë votimi të cilat kanë vulën e hyrjes ose çdo shënim tjetër për këtë gjë në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në orën e mbylljes së votimit brenda vendit, sipas këtij Kodi.
2. KQZ-ja dërgon nëpërmjet shërbimit postar fletët e votimit dhe çdo material tjetër zgjedhor dhe informativ në adresën e deklaruar të vendbanimit të zgjedhësit sipas listës së zgjedhësve për votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Fleta e votimit është e njëjtë, por me një element të veçantë dallues me fletën e votimit që përdoret brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Fletët e votimit të plotësuara nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të sekretuara dërgohen në adresën zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet shërbimit postar. Shpenzimet për dërgimin dhe kthimin e fletës së votimit dhe çdo material tjetër zgjedhor dhe informativ nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tek votuesit nga jashtë paguhet nga KQZ-ja. KQZ-ja fillimisht bën përpjekje të përzgjedhë ofrues ndërkombëtarë të shërbimit postar me jashtë vendit, që kanë eksperiencë dhe reputacion të mirë në shërbimin e postës së shpejtë, dhe zgjedhja e tij realizohet nëpërmjet procedurave më afatshkurtra që mundëson legjislacioni për prokurimin publik.